

ÇDO FËMIJË NË SHKOLLË!

Newsletter nr 5, 9 Tetor 2015

Përmbledhje Mujore

Në kuadër të programit “OOSC – Out of School Children”



Nisma “Çdo fëmijë në Shkollë” mbështetet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe UNICEF, dhe zbatohet nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve. Kjo nismë ka për qëllim monitorimin e situatës aktuale të sistemit arsimor të Shqipërisë lidhur me çështjen

e fëmijëve që kanë braktisur shkollën dhe ata që rrezikojnë ta braktisin. Kjo nismë synon nxitjen dhe mbikëqyrjen e procesit të komunikimit dhe raportimit mbi fëmijët në rrezik braktisjeje.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, një nismë e UNICEF Shqipëri, ka zhvilluar një mekanizëm që lejon mbledhjen e informacionit dhe nivel rajoni (Qarku) në lidhje me situatën dhe të drejtat e fëmijëve.

Si pjesë aktive dhe integrale e shoqërisë civile në çdo rajon, Observatori bashkëpunon me aktorë publikë dhe privatë në procesin e mbledhjes sistematike të të dhënave dhe nxjerrjen e raporteve dhe relacioneve informuese në lidhje me të drejtat e fëmijëve, zbatimin e ligjeve në këtë fushë dhe identifikimin e nevojave për përmirësime.

Unë besoj se Observatori për të Drejtat e Fëmijëve me eksperiencën 5 vjeçare në sektorin e shoqërisë civile, është një kandidat potencial i aftë për të përfaqësuar dhe trajtuar me profesionalizëm dhe koherencë çështjet e të drejtave të fëmijëve në vend

-Znj. Klajda Gjoshaj, Ministër i Integritimit European (Janar, 2014)

Faza e parë dhe e dytë e projektit “Çdo fëmijë në shkollë”

Në fazën e parë të zbatimit të nismës është arritur finalizimi i:

- Marrëveshjes 4 Ministrore (M4M) “Për identifikimin dhe rregjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor” 02. 08. 2013
- Urdhërit 3 Ministror (U3M) për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit datë 02. 08. 2013 “Për identifikimin dhe rregjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të

moshës së detyrimit shkollor” 02. 08. 2013

Në këtë fazë të dytë, entiteti zbatues Observatori për të Drejtat e Fëmijëve përpunon çdo muaj një informacion periodik në lidhje me ecurinë e kësaj nisme dhe objektivat strategjike për muajt e ardhshëm.

Arritjet e nismës për muajin Shtator 2015

- ✓ Takim me rrjetin/ grupin e punës për ndërmarrjen e angazhimeve për zbatimin e fazës së dytë;
- ✓ Nxitja e komunikimit ndërmjet Ministrive dhe Institucioneve vartëse për zbatimin e U3M (5 Janar 2015);
- ✓ Nxitja e MSh dhe MB që të nxjerrin listat e fëmijëve në moshë shkolle për tu regjistruar në klasë të parë në fillim të këtij viti akademik (14 Shtator 2015), - si një nga detyrimet rrjedhëse të zbatimit të U3M;
- ✓ Hartimi i Metodologjisë së *monitorimit për vlerësimin e praktikave që zbaton shkolla* në procesin identifikues të fëmijëve që duhet të ndjekin klasën e parë, ashtu dhe të fëmijëve që janë në rrezik braktisje shkolle, - si një nga detyrimet rrjedhëse të zbatimit të U3M; Intrumenta të vlerësimit të këtyre praktikave janë Intervistat dhe fokus grupet;
- ✓ Si rrjedhojë e hartimit të metodologjisë për *monitorimin e vlerësimit të praktikave që zbaton shkolla*, do realizohet një raport studimor në Tetor 2015 (para se të fillojë cikli i trajnimeve dhe shkëmbimeve mes shkollave) dhe një raport studimor krahasimor bazuar në po të njëjtën metodologji në Maj/ Qershor 2015.
- ✓ Përzgjedhja e Bashkisë Durrës, si një zonë pilote për monitorimin e U3M, vlerësimin e praktikave të shkollës dhe trajnimin e tyre për të identifikuar fëmijët jashtë dhe në rrezik braktisje shkolle;
- ✓ Përcaktimi i 10 shkollave pilot në të cilat do të monitorohet zbatimi i U3M në Bashkinë Durrës, sipas kriterëve të përcaktuara në metodologji;
- ✓ Realizimi i draftit të parë të Udhëzuesit për trajnimet që do të realizohen në 10 shkollat pilot, Udhëzues i cili detajon detyrat në zbatim të U3M, si dhe ju prezanton shkollave praktikant për identifikimin e fëmijëve braktisës ose në rrezik braktisjeje;
- ✓ Takime paraprake me DAR Durrës, institucionet lokale aktorë në zbatim të U3M, si dhe takim me drejtuesit e 10 shkollave pilot të Bashkisë Durrës;
- ✓ Zyrtarizimi i procesit të pilotimit me DAR Durrës;
- ✓ Nxitja dhe mbikëqyrja e procesit të komunikimit dhe raportimit mbi fëmijët në rrezik braktisjeje.

Angazhimet: Tetor – Nëntor 2015

- Realizimi i procesit të plotësimit të intervistave dhe fokus grupeve në 10 shkollat pilot;
- Përpunimi i intervistave dhe fokus grupeve të realizuara në 10 shkollat pilot;
- Përgatitja e raportit baseline;
- Finalizimi i Udhëzimit për trajnimin e 10 shkollave pilot;
- Nxitje dhe komunikim permanent me Ministrinë e linjës për të intensifikuar komunikimin me institucionet vartëse në zbatim të U3M;
- Dokumentimi i ecursisë së zbatimit të nismës;
- Trajnime me 10 shkollat dhe komunitetin në lidhje me zbatimin e U3M në Bashkinë Durrës;
- Angazhim për të identifikuar fëmijët që janë jashtë sistemit arsimor në Bashkinë Durrës.

Lista e Shkurtimeve

U3M – Urdhër 3 Ministror

MSh – Ministria e Shëndetit

MB – Ministria e Brendshme

DAR – Drejtoria Arsimore Rajonale

M4M – Marrëveshje 4 Ministre



OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

Bulevardi "Bajram Curri", Pall "Agimi", Shk 5, Ap 81, Tiranë
 Tel: 00355 4 258 987 | e-mail: info@observator.org.al | web:
 www.observator.org.al